




Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 19 (paragrafi 11) të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit (nr.01/2014), Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 04.08.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-1491-14 për z.Kujtim Kërveshi – Anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë se ka konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, si Anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), lidhur me vendimmarrjen e caktuar, që ka të bëjë me lidhjen e Memorandumit për Bashkëpunim në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD).

Zyrtari i lartë, z.Kërveshi në momentin kur është diskutuar dhe votuar në Këshillin Prokurorial të Kosovës për lidhjen e këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, ka deklaruar konfliktin e mundshëm të interesit dhe ka kërkuar të tërhiqet nga diskutimi dhe votimi.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-1491-14, për Zyrtarin e lartë, z.Kujtim Kërveshi – Anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe themelues i Organizatës jo qeveritare “Institutit i Kosovës për Drejtësi”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Kërveshi fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës ai është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç’rast është biseduar për situatën për të cilën dyshohet, si dhe është kërkuar nga ai që të vërtetoj me shkrim deklaratimet e tija se është tërhequr nga diskutimi dhe vendimarrja lidhur me aprovimin e memorandumit të bashkëpunimit mes Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Zyrtari i lartë, z.Kërveshi është deklaruar se; janë Procesverbalet e Mbledhjeve të KPK-së ku mund të shihni se kam deklaruar se dua të tërhiqem edhe nga diskutimi edhe nga votimi për këtë çështje.

Ndërkohë, ne kemi kërkuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës Procesverbalet nga dy Mbledhjet e fundit të vitit 2013 dhe ato i kemi marr, me numër protokoli AKK-03-2751-14, e të cilat na kanë shërbyer si informacion i saktë i deklarimit dhe shmangies së zyrtarit të lartë, ztr. Kërveshi, nga konflikti i mundshëm i interesit.

Gjatë leximit të Procesverbalit nga Mbledhja e KPK.Nr.257/2013 e datës 22.11.2013, shihet se kur ka ardhë në diskutim pika katër e rendit të ditës; “Shqyrtimi i kërkesës së Institutit Kosovar për Drejtësi lidhur me Memorandum Bashkëpunimi në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe Institutit Kosovar për Drejtësi (IKD)”, z.Kërveshi, ndër të tjera ka deklaruar si vijon: *“...dua të them se unë nuk kam as konflikt potencial të interesit, sepse nuk kam kurrfar roli në këtë Institut, por unë me korrektësi kisha dashur me më liruar prej kësaj pike. Mua ju lutem më lironi”*.

Sipas Procesverbalit, shihet se Anëtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës në këtë Mbledhje janë pajtuar në parim për nënshkrimin e këtij Memorandumi për Bashkëpunim, por votimi nuk është bërë pasi që Kryetari i Këshillit Prokurorial ka kërkuar edhe disa informacione shtesë.

Kjo pikë pastaj ka qenë edhe një nga pikat e Rendit të ditës në Mbledhjen pasuese të KPK-së të datës 27.12.2013.

Në Mbledhjen e KPK-së të datës 27.12.2013, pika “V” e Rendit të ditës pra, ka qenë; “Shqyrtimi i Memorandumit për Bashkëpunim mes KPK-së dhe IKD-së, lidhur me Planin e Veprimit për ngritjen e efikasitetit të KPK-së në luftimin e veprave penale të korrupsionit.

Gjithnjë duke ju referuar Procesverbalit të Mbledhjes së KPK-së, Nr.17/2014, që në Agjencinë kundër Korrupsionit ka ardhë pas kërkesës zyrtare të AKK-së, dhe ka numër protokoli; AKK-DPK-03-2751/14, shihet se z.Kërveshi, me tu hapur kjo çështje për diskutim, përsëri ka kërkuar të lirohet nga diskutimi dhe votimi në prezencën e tij, për arsye të njehta sikur herën e parë. Dhe, kërkesa e tij është aprovuar nga Kryetari i Këshillit Prokurorial të Kosovës, njëkohësisht Kryeprokurori i shteti z.Ismet Kabashi.

Pas diskutimeve të Anëtarëve tjerë, Kryetari i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z.Kabashi ka nxjerr këtë konstatim: “Anëtarët e KPK-së njëzërit kanë aprovuar nënshkrimin e Memorandumit për Bashkëpunim në mes të KPK-së dhe IKD-së, lidhur me Planin e Veprimit për ngritjen e efikasitetit në luftimin e veprave penale të korrupsionit”.

Ky konstatim ka edhe sqarimin e bashkangjitur: “Në këtë votim votuan 7 anëtar të KPK-së, pasi që Teki Bokshi ka munguar në këtë takim, ndërsa z.Kujtim Kërveshi është larguar nga pjesëmarrja në diskutim dhe votim në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës”.

Këto janë fakte të mjaftueshme që dëshmojnë se zyrtari i lartë, z.Kërveshi ka parandaluar situatën e konfliktit “rast pas rasti” të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në mbështetje të nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit

